

# THE SYMBOL OF THE SERPENT IN ALBANIAN LITERATURE

**Zenepe BRAKO**

University of Durrës „ Aleksandër Moisiu“, Faculty of Education, English Language and

Literature

zenepe.brako@outlook.com

**UDC 821.18.09**

*Conference paper*

## **Abstract**

In 1971, Edward Burnett Tylor, defines culture or civilisation as a complex group in which includes connections, beliefs, art, moral, justice, consume and every other ability or tradition gained by a person in a community. The individual as part of his culture embodying his belief and non-beliefs which are necessary for his intellectual and emotional growth. By intellectual/emotional growth we define handing down tradition from generation to generation in civilization world.

This statement means that we have to sharpen the senses and to awaken someone's ethnic desires in order to create courage and amazement. We cannot say that this statement includes some parts of an output but a part of it which is a meaningful element, definitely yes. Through this philosophical and anthropological approach, we are going to define the snake as a symbol, symbolic, symbiosis, metamorphic and all his possible ethnonyms in albanian cultural plain. The faithful and reproductive power of pagan and totemic beliefs of Albanians, recognizes its special production, so the figure of the snake, even as a romantic and lyrical form, lurks in the arena of ethnological and character studies both quantitative and qualitative.

**Key words:** *Serpent, Symbol, Literature, Folklor, etc.*

## **Përmbledhje**

Kur përmendet kjo krijesë ajo që na vjen ndërmend për të mund të jetë shumë ndjesore, sepse e vërteta është se që prej kohërave mitike e deri sot, figura e tij ka ndryshuar në një metamorfozë interesante dhe aq mistike e të habitshme. Ajo çka ne na intereson në këtë punim është të parit të tij në shfaqjet folklorike shqiptare, pra, cila është lidhja e Ilirëve por dhe e gjithë pasardhësve të tyre me gjarprin, çfarë përfaqëson ai dhe si ka evoluar, ndryshuar ky simbol nga kult në fobi, e me pas në simbol letrar?

**Fjalët kyçe:** *Simbol, gjarpër, Ilir, kult, folklor.*

## Kulti i gjarprit

Ndër shqiptarë por edhe në popuj të tjerë indoeuropianë ka disa qënie për të cilat është menduar se kanë attribute të mbinatyrshme, si: sorkadhja, dhia e egër, derri, nuselala, ujku etj. Më i veçanti është ai i kultit të gjarprit. Atë e vërejmë si gjallesë të tokës e të nëntokës, të shpellave dhe të ujrave. E ndeshim edhe si hyjni, mbrojtës të jetës e të mbarësisë familjare, si simbol i pjellorisë gjithashtu. Ky kult me atributet e tij religjioze është ruajtur sidomos në viset fshatare malore por jo vetëm dhe është dëshmuar përmes rritesh e besimesh.

Gjurmët e tij vërehen në disa zhanre të krijimtarisë popullore. Besimet për gjarprin kanë evoluar shumë, janë shndërruar e kanë pësuar ndërfutje nga dukuritë e tjera religjioze por me kuptime gjenetike të ndryshme. Në Azinë e vogël – shumë vende mbanin emrin e **Osiffit** (një gjarpri përbindës). Gjarpri **Naga** – Indi, gjarpri i mbinatyrshëm i lumenjve. **Hidra** greke – gjarpri i ujrave që e kishte banesën pranë një burimi. Në Arabi burimet janë paraqitur si banesa të xhindeve, demonëve të shkretëtirës që më së shumti janë paraqitur në formë **gjarpri**. Megjithë këtë jo në çdo rast ai mund të jetë objekt i kultit religjioz. Mundësia e të qenit ose jo të diçkaje si objekt kulti nuk e përjashton aspak trashëgiminë e besimit në vetitë e mbinatyrshme të gjallesave, sendeve, a dukurive të veçanta.

## Kulti i gjarprit tek Ilirët

Studiuesit në sajë të një materiali mjaft të gjerë kanë arritur në përfundimin se një nga vatrat ku ky kult ka pasur një vend dhe peshë të veçantë kanë qenë trojet ilire.<sup>1</sup> Për më tepër ky kult ka pasur vazhdimësi edhe tek arbërit e mesjetës e deri tek shqiptarët e sotëm. Nga kërkimet e shumta në terren nuk kemi ndeshur në asnjë rast ku në bisedat me të moshuar (60 vjeç e lart) në vitet '60 të shekullit XX që të mos e kujtojnë në mënyrë të kënaqëshme besimet, rritet, e praktikat magjike që kanë të bëjnë me kultin e gjarprit, në mënyrë të veçantë të atij që në popull konsiderohej si qënie e mbinatyrshme e tokës dhe nëntokës.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> R. Ferri, *Prilog poznavonja Ilirske mitologie*, Dubrovnik 1953 fq. 419-429.

<sup>2</sup> Mark Tirta, *Mitologjia ndër shqiptare*, ASHSH, Tiranë, 2004, fq. 147.

## Emërtime dhe kuptime

Në popullin tonë gjarpërinjtë njihen me emra të përgjithshëm “gjarpërinj”, por edhe me emra të ndryshëm sipas besimeve. E për rrjedhojë kemi:

Gjarpër

Bollë

Brevë

Nëpërkë (nuk ka atribut kulti)

Bullar

Buç

Grabovç

Skrapth (nuk ka atribut kulti)

Kur bagëtinë e pickonte gjarpri a nëpërka thonin: *E ka zënë dheu*. “Në pranverë shpeshherë gjanë e gjallë e zë dheu”. Gjarpërin e shtëpisë në vise të tjera të Shqipërisë e ndeshim me emra të ndryshëm.

Në jug si:

Rrëzë Tepelenës

Brataj të Vlorës

Dardhë të Beratit

Myzeqe e njohim si Vitore.

Vlen të përmendim se në zonat jugore Vitore përmendet edhe me kuptim të figurshëm, për të treguar një grua të bukur e të shkathët. Kjo dëshmohet edhe nga këngët popullore, një prej të cilave nga Reza e Përmetit:

I hoqe kyçet brezit / si trimi armët e mezit / emrin e keshe grua / por jeshe trim e fajkua /  
vërje peqin ndër brez / merrje punën me ers / o Vitorja në mur / kur rrije lëshoje nur / gjithë  
jetën me nder / të buron goja sheqer.<sup>3</sup> Hahni thotë se në Elbasan fjala Vitore është përdorur për  
gruan që lind shumë fëmijë.<sup>4</sup> Te shqiptarët e Greqisë, Vitoret janë 3 fatitë a të mirat që i vijnë  
foshnjës natën e tretë tek djepi e i caktojnë fatin që do të ketë në jetë.

Sipas Arbëreshëve të Italisë: “Vitorja është një gjarpër i vogël që zakonisht gjendet nëpër  
shtëpia dhe për të ka një besim të mbinatyrshëm si ruajtës i shtëpisë”.<sup>5</sup> Në Nikaj – Mërtur gjarpri  
njihet si tokë, që do të thotë zot i tokës. Nga besimet popullore vihet re se gjarpri shihet si forcë

<sup>3</sup> Johan Georg fon Hahn, *Këngë popullore lirike*, Tiranë, 1995, fq. 242.

<sup>4</sup> Johan Georg fon Hahn, *Këngë popullore lirike*, Tiranë, 1995, fq. 326.

<sup>5</sup> Dhimitër Kamarda, *Apprendice al saggio di gramatologia comparatta alla lingua albanesse*, Prati, 1886, fq. 70.

zotëruese e tokës. Në veri e në jug vihet re se ruhet kujtimi i ndalimit (tabusë) së prekjes së gjarprit. Në disa krahina thuhet se po të mbytësh një gjarpër të nesërmen të dalin përpara tre të tillë e të zënë rrugën. Diku mbytjen e gjarprit e lidhin me fatkeqësi në prodhimet bujqësore.

### **Toponime**

Vend të veçantë gjarpri zë edhe në toponime të ndryshme. Më poshtë po paraqesim disa prej tyre:

Gjarpri i Dragobisë – Alpe

Gjarpri i Ceremit – Alpe

Gjarpri i Mulosmanajve – Alpe

Gjarpri i Breshivanëve – Alpe

Guri i Gjarpri – Tomorricë

Fusha e Bullit – Elbasan

Qafa e Bullit – Bulqizë

### **Gjarpri në krijimtarinë popullore**

Për sa i përket krijimtarisë popullore ai zë një vend të veçantë sidomos në këngët legjendare që na vijnë nga mesjeta balada, përralla e gojëdhëna të ndryshme mitike. Në këtë pikë gjarpri na paraqitet i dyzuar, ndonjëherë na shfaqet si përbindësh dhe simbol i së keqes por më së shumti pas kësaj na vjen si mbrojtës i së mirës dhe përkrahës i njerëzve në momente të vështira.

Në folklore gjejmë gjarprin e frikshëm që papritur kthehet në Orë (një vajzë e bukur që kryen funksionin e mbrojtjes së njerëzve). Kur Kreshniku shpëton një gjarpër nga djegia e lëndës së pyllit ai kthehet në gjarpër që kishte qënë Ora dhe si shpërblim i jep forcë për të vrarë armiqtë dhe për të vënë drejtësi në popull.<sup>6</sup> Në Këngët e Kreshnikëve gjarpri del si shëruesi i plagëve të Mujit të plagosur. “Nandë soj barnash për nën gjuhë m’i ka, / tri herë në ditë tanë varrët po m’ia lan“. Ai paraqitet edhe si këndues këngësh magjike: “Se kur dhimbët tepër po më lodhin, / atëherë nis gjarpri me këndu / mji soj kangësh qi kurrkund s’i ndi / harroj dhimbat edhe bi n’kllapi.<sup>7</sup>

Po në Këngë të Kreshnikëve gjarpri na del si një simbol prej nga trimat marrin forcë. Në shumicën e rasteve ata kanë nga dy a tre gjarpërinj në gjoks, megjithë këtë kjo vërehet edhe në

<sup>6</sup> Qamil Haxhihasani, *Këngë popullore legjendare*, Tiranë, 1995, fq. 89-90.

<sup>7</sup> Qamil Haxhihasani, *Këngë popullore legjendare*, Tiranë, 1995, fq. 191, 302- 303 dhe 207.

besimet popullore. Fill te mreti krali kenka shku / - U thot: e preva Musen Qesexhi / me pa dit' ti, musa se kush asht, / para vetit Musen e kinje vnue / njaj Musa ish pa' ken' Drangue, / kurr njati shoqi n'bot s'i ka le / se tre gjarpinj n'bark i ka pas / nja e kish çuet, dy i kish fjetë.

Në përrallat popullore gjarpri na del edhe e kundërta, siç është rasti i kuçedrës. Që u bën dëm njerëzve. Në këto raste tregohet se si njeriu e mbyt kuçedrën çka tregon fitoren e njeriut mbi të keqen. Në disa përralla të tjera gjarpri na del me një kuptim të ri, atë të shejtanit. Ky kuptim vjen nga besimet monotesiste, zakonisht janë nga interpretimet e krishtërimet të përdorur me dy qëllime: së pari - për të shpjeguar me krijesa konkrete kundërvënësin ndaj perëndisë së krishterë dhe së dyti - për të zhdukur mbeturinat e mbetura nga kultet pagane që ruheshin në popullin tonë.

Një nga legjendat më interesante ku mund të shohim shfaqjen e këtij simboli kaq të larmishm në domethënien e vet e jo vetëm shtatë saç ka lëkurë në gojëdhënat tona është ajo e “djalit gjarpër”. Një grua pas 9 vjetësh lind një djalë gjarpër. Kur ky u rrit kërkoi të martohej me vajzën e mbretit. Që kjo martesë të kryhej mbreti dha si kusht që ti shtrohej me flori një rrugë shtatë sahat e gjatë. Me fitimin e bastit djali gjarpër u martua me vajzën e mbretit.

Pasi kohët kalonin e ëma e djalit habitej sesi nusja ishte e kënaqur nga martesja me një gjarpër. Kur flet me të ajo i tregon se ai nuk ishte një gjarpër, natën, ai hiqte shtatë lëkurë dhe kthehej në një djalë të bukur të pashoq. Që djali të mos kthehej më në gjarpër e ëma ia djeg lëkurët dhe djali vdes. Siç del në këtë legjendë këtu kemi shfaqjen e gjarprit në një nga format e totemit, atë të transformimit nga kafshë në njeri.

Një studiues i huaj, Maximillian Lambertz, në një studim të zgjeruar mbi përrallat shqiptare duke theksuar mbi të gjitha karakterin autokton të tyre ndër të tjera do të shprehej kështu për karakterin figurën në fjalë: “Kuçedra shqiptare është, sipas thelbit të saj qenësor, kuçedër e motit, një demon shtrëngatë. Të gjitha funksionet e tjera që ajo kryen janë të dorës së dytë.

Kuçedra nga ana tjetër, shfaqet në përrallën shqipe në disa funksione të saj që nuk kanë të bëjnë me vetinë e saj prej demoni shtrëngatash. Ajo është thjeshtë krijesë e ligë e përrallës dhe luan rolin e ujkut sikurse te përralla e kësulëkuqes, atë të përbindëshit me nëntë koka në përrallën e Andromedës e të Perseut, atë të kafshës që ka shpirtin e një demoni të ligë, atë të vjehrrës së keqe, apo të shtrigës në përrallën e arratisë magjike, atë të Resë Dinake të mashtruar në përrallën e Tsanit.<sup>8</sup>

---

<sup>8</sup> Alma Dema, *Gjurmime të mendimit etnologjik në lëmin e përrallave*, Durrës, 2018, fq. 67-68.

## Gjarpri si simbol në letërsi

Përveç simbolikës polisemantike në letërsinë gojore, në përrallat popullore shqiptare gjarpri na shfaqet edhe në autorë të letësisë së shkruar shqipe. Sigurisht përfaqësuesi me i denjë e më i shpeshtë i tij mbetet Martin Camaj, por konfirmimin e gjithë kuptimësisë dhe kultit të tij e hasim edhe tek Qosja. Ky i fundit në romanin e tij “Vdekja më vjen prej syve të tillë” përdor këtë simbol mitik.<sup>9</sup> Ky simbol në rrafshin semantik shpreh një domethënie të caktuar, kuptim poetik, që bëhet pjesë e strukturës tekstore.

*“Dikur moti në kohën e babagyshit tim, kur luftonim me kuçedrat, dragonjtë krahëshpejtë e kishin fshehur thesarin e nuseve të qytetit në shpellën e harapit – thoshte plaku i parë. Shpella e harapit e ruan një kuçedër e madhe; thesari ia freskon lekurën e djegur dhe çdo njëri që provon të ngjitet atje e helmon, - thoshte plaku i tretë”.*<sup>10</sup>

Megjithëse në këtë veprë moderne të letërsisë sonë ky simbol mitik vjen i rifunksionalizuar, ai e ruan kuptimin e gjenezës semantike të tij, atë të të qenit i mbinatyrshëm dhe mistik. Pasi kudo që ai shfaqet na përcjell pashmangshmërisht një ndjesi të misterit, të diçkaje a dikujt që nuk zbulohet a nuk mundet të njihet prej nesh shterueshëm. Ashtu siç e thamë më lart, shfaqjen e rifunksionalizuar, në të gjitha funksionet e tij semantike mitike gjarpri e merr në veprën e Martin Camajt.

Simboli i gjarprit në veprën e Camajt lidhet me vetë ekzistencën e shqiptarit, me etninë, kombin, dhe lashtësinë e origjinës duke e sjellë atë në pothuajse të gjitha vëllimet e tij. Gjarpri i Camajt shfaqet si mall, si frika ndaj vdekjes, si totem ilir, si simbol i gruas, si simbol biblik, etj, Gjarpri pagan, gjarpri biblik, gjarpri dukagjinas, gjarpri arbëresh, mbrojtësi i vatrës, ruajtësi i varrit, kryepar i fisit ilir, joshës i mëkatit, personifikim i plleshmërisë, simbol i mënçurisë dhe i së keqes ësthtë i pranishëm e i endur mjeshtërisht në dhjetra motive<sup>11</sup> Ai i qenësishëm tek Camaj më shumë, ku konkretisht mund se kudo e kushdo tjetër që ka shkruar shqip, ku konkretisht disa prej të cilave mund të të pëmendim: *poezia “Gjarpni”, “Gjarpni e gruaja”, “Gjarpijtë” etj.*

<sup>9</sup> Alma Dema, *Gjurmime të mendimit etnologjik në lëmin e përrallave*, Durrës, 2018, fq. 29-30.

<sup>10</sup> Rexhep Qosja, *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, Rilindja, Prishtinë, 1980, fq. 12.

<sup>11</sup> Koçi Petriti, *Në poetikën e Martin Camajt*, Tiranë, 1997, f. 103.

## **Përfundimi**

Në përfundim të këtij punimi disa konkluzione që mund ti nxjerrim janë:

Sipas dëshmive të mbledhura prej shumë studiuesve, kulti i gjarprit ndeshet gati njësoj në të gjithë Shqipërinë, në të gjitha viset e banuara nga shqiptarë e në të gjitha trevat e banuara nga Ilirët sidomos në trevat perëndimore të Ballkanit perëndimor. Krahas ruajtjes së kultit të gjarprit si mbrojtës i shtëpisë vërehet edhe ruajtja e kultit të gjarprit në përgjithësi. Kjo shfaqet në shprehjen e mbeturinave të tabusë së përmendjes së emrit, të prekjes e aq më pak të mbytjes së tij.

## **Bibliografia**

- DEMA, Alma (2018). Gjurmime të mendimit etnologjik në lëmin e përrallave, Durrës.
- FERRI, R. (1953). Prilog poznavonja Ilirske mitologie, Dubrovnik.
- HANG, Johan Georg fon (1995). Këngë popullore lirike, Tiranë.
- HAXHIHASANI, Qamil (1995). Këngë popullore legjendare, Tiranë.
- KAMARDA, Dhimitër (1886). Appendice al saggio di gramatologia comparata alla lingua albanese, Prati.
- PETRITI, Koçi (1997). *Në poetikën e Martin Camajt*, Tiranë.
- QOSJA, Rexhep (1980). Vdekja më vjen prej szve të tillë, Prishtinë: Rilindja.
- STIPÇEVIQ, Aleksandër (1983). Simbolet e kultit tek Ilirët, Prishtinë: Rilindja.
- TIRTA, Mark (2004). Mitologjia ndër shqiptare, Tiranë: ASHSH.